

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **Spitali i Përgjithshëm Gjilan**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **220/70001-26-5789-1-1-1**

Sa i përket tenderit për: "Ri-tender Furnizim me Aparatura Mjekësore për Repartin e Hemodializës"

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Medi Health L.L.C. _____
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)
Preoc, Magj. Ferizaj - Prishtinë, p.nr _____
(Adresa)
Graçanicë _____ (Kodi postar) _____
(Vendi)
+38344900523 _____
(Numri Telefonit) (Numri i Faks-it) _____
Saim Krasniqi _____
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)
medihealthllc1@gmail.com; info@medihealth-rks.com;
(Adresa elektronike)
09.09.2026 _____
(Data e parashtrimit të kërkesës)



*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

- Njoftimi për kontrate 15.07.2026
- Hapja e ofertave .04.08.2026
- Njoftimi mbi vendimin e AK-se 25.08.2026
- Kërkesa për ri shqyrtim 30.08.2026
- Vendimi i AK-se – refuzimi 31.08.2026

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☒

Jo ☐

Hapja e ofertave 04.08.2026

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒

Jo ☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒

Jo ☐

Operatori Ekonomik ankues Medi Health L.L.C, me datën 30.08.2026, ka parashtruar kërkesë për ri shqyrtim kundër vendimit të AK -se dhe ka prezantuar prova, dëshmi dhe argumente tjera të mbështetura me dispozita ligjore edhe për kundër ketijë fakti AK, perseri refuzon kërkesën dhe le ne fuqi vendimin e sajë kundërligjore.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Ligji për prokurim publik, nr 04/L-042 i amandamentuar meligjet tjera

- Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi
- Neni 28 Specifikimet teknike
- Neni 51 Njoftimi i Kritereve të Përzgjedhjes
- Neni 52 Njoftimi i kritereve për dhënien e kontratës
- Neni 56 Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënien e Kontratave
- Neni 69 – kapaciteiti teknik dhe profesional
- Neni 70 – Standardet për sigurimine Cilesise
- Neni 108/A – Zgjidhja preliminare e mosmarreveshjeve

Rregullorja me nr. 001/2022, per Prokurim Publik

- Neni 25 Kriteret e përzgjedhjes
- Neni 97 Shkeljet e rënda

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshtetja rrëthanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuara për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Te nderua,

Autoriteti Kontraktues – Spitali i Përgjithshëm – Gjilan - Zyrtari përgjegjës i prokurimit me datën 25.08.2026, ka publikuar formularin B58 – Njoftimin mbi vendimin e AK-se , për këtë procedurë të prokurimit dhe tenton të eliminon kompaninë të kundershtueshme ndërsa rekomandon për dhënie të kontratës kompani tërësisht të pa përgjegjshme në të gjitha aspektet.

Pretendimi ankimor 1

AK – Spitali i pergjitheshem - Gjilan, ne leter standarde mbi eliminimin e ofertës sonë ka potencuar mungesen e Aneksit 1 !

Ne FDT, pika 3.1 te Dosjes se tenderit eshte kërkuar

“Deklaratën për specifikacionet teknike për mallrat e ofruara të cilat përputhen me ato të përmendura në Aneksin 1 të dosjes së tenderit.”

Ndërsa tek kerkesat e kapaciteti teknik apo profesional — Kërkesa nr 3, keni kërkuar

“Deklaratë për Specifikimin Teknik për Mallrat e Ofruara dhe Katalogun origjinal të prodhuesit.”

Nga këto kërkesa rezulton qe Aneksi 1, është dokumenti i AK-se dhe që përmban specifikimet teknike të detyrueshme dhe shërben si pikë reference, ku FDT nuk e përcakton Aneksin 1, si formular që duhet plotësuar, nënshkruar apo dorëzohet nga tenderuesi.

Dokumenti që kërkohet nga OE është deklarata - specifikimi teknik për mallrat e ofruara, së bashku me katalogun origjinal të prodhuesit.

Në ofertën tonë është dorëzuar dokumentacioni teknik për mallrat e ofruara, përfshirë deklarinimin dhe specifikimin teknik dhe katalogët e prodhuesit, pra vetë vendimi pranon shprehimisht se katalogu është dorëzuar, por nuk identifikon dokumentin konkret të ofertës që është shqyrtuar dhe nuk tregon cilën pikë të specifikimit nuk e mbulon dokumentacioni ynë dhe nuk citon asnjë dispozitë të FDT-së që kërkon “Aneksin 1” si dokument të veçantë të tenderuesi, rrjedhimisht AK e ka barazuar në mënyrë të gabuar dy gjëra të ndryshme përkatësisht aneksin 1 te hartuar nga ve AK dhe deklarata - specifikimet teknik të hartuar nga OE.

Ky ndryshim i standardit të vlerësimit pas afatit për ofertim bie ndesh me nenet 27, 51 dhe 59.4 të LPP-së dhe me parimin e transparencës te përcaktuar me nenin 7 te LPP-se, prandaj eliminiimi i ofertës sonë për kërkesa që nuk kanë qenë pjesë të Dosjes së Tenderit, përbenë shkelje të rëndë të Ligjit të Prokurimit Publik neni 51 dhe 53 par 3, ku për këto veprime haptazi tendencioze ndaj ofertës sonë nga zyrtari përgjegjës i prokurimit duhet te sanksionohen nga OSHP, si organ përgjegjës dhe duhet te njoftohet KRPP, zyrtarisht dhe te kerkohet te zbatohet neni 25, par 8 i LPP-se ndaj zyrtarit përgjegjës te prokurimit.

Pretendimi ankimor 2

AK – Spitali i pergjitheshem - Gjilan, ne FDT, tek kerkesat e kapaciteiti teknik dhe profesional , kërkesa 5, ka kërkuar:

“Operatori Ekonomik ofertues duhet të dëshmojë se ka Serviser të Certifikuar nga Prodhuesi i Pajisjeve të ofruara në këtë tender.”

Kjo pikë kërkon dy elemente baze, ekzistencën e serviserit dhe certifikimin e tij nga prodhuesi dhe nuk kërkon që serviseri të jetë punonjës i përhershëm i ofertuesit dhe nuk përcakton si dëshmi të detyrueshme kontratë pune, parakontratë, marrëveshje bashkëpunimi apo deklaratë angazhimi.

Vendimi i AK-se, konfirmon se në ofertë gjenden certifikata të prodhuesve si certifikata e prodhuesit B. Braun për Dion Bullatovci dhe certifikata HUMAN, për Riste Soskoski, rrjedhimisht AK nuk e bazon eliminimin në mungesën e certifikimit nga prodhuesi por e bazon në mungesën e një forme të caktuar të marrëdhënies juridike, të cilën FDT nuk e kishte të përcaktuar fare dhe eliminimi i një oferte me asrsyetim të tillë apo ne kundërshtim me kërkesat e dosjes se tenderti konfirmon shkelje bazike të dispozitave ligjore nga neni 52, par 3 dhe neni 56, par 3 të LPP-se, ku OSHP, si instance përgjegjëse duhet të veproj ndaj zyrtarit përgjegjës të prokurimit dhe të kërkoj nga KRPP, që ta sanksionoj ashtu siç përcaktohet me nenin 25.8 të LPP-se.

Neni 69.8 i LPP-së, lejon që një OE të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, pavarësisht natyrës juridike të lidhjeve, me kusht që disponueshmëria e burimeve të dëshmohet, prandaj, fakti se një person potencialisht nuk është pjesë e stafit të brendshëm nuk është shkak për eliminim dhe në veçanti AK nuk e ka shpjeguar pse certifikata B. Braun për Dion Bullatovcin, nuk mjafton për pajisjen përkatëse dhe ka bashkuar vlerësimin e dy certifikatave në një përfundim të vetëm prandaj arsyetimi i tillë i eliminimit të ofertës sone nuk është i individualizuar, nuk tregon se cila pajisje mbetet pa mbulim nga serviseri i certifikuar dhe nuk demonstroi zbatim të kërkesës së FDT-së sipas përmbajtjes së saj reale pasi që në FDT është kërkuar qartë që OE duhet të dëshmojë se ka Serviser të Certifikuar nga Prodhuesi, Medi Health ka dëshmuar këtë me Certifikatat e dorëzuara në ofertën tonë.

Pretendimi ankimor 3

Arsyetimi tjetër i eliminimit lidhur me çmimin më i lartë nuk është arsye për papërgjegjshmëri, pasi që sipas neni 60.1 të LPP-së dhe pikës 31.1 të FDT-së, kriteri është *“tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët”* dhe renditja sipas çmimit bëhet vetëm ndërmjet tenderëve që fillimisht kanë kaluar vlerësimin e përgjegjshmërisë, prandaj, çmimi më i lartë i kompanisë sone “Medi Health”, nuk është kriter administrativ, teknik apo profesional dhe nuk mund të paraqitet si shkak i tretë për ta shpallur ofertën të papërgjegjshme rrjedhimisht përfshirja e çmimit si shkak skualifikimi përbën tejkalim të kompetencave ligjore dhe shkelje flagrante të neni 60 të LPP-së.

Pretendimi ankimor 4

Pas kërkesës sonë për ofrim të qasjes në ofertën e kompanisë së rekomanduar dhe *“lejimi rrejtshëm”*, pa dhënë asnjë kopje të dokumenteve jo-konfidenciale, nuk e përmbush të drejtën për qasje dhe kopje sipas neni 10 paragrafët 3, 4 dhe 5 të LPP-së pavarësisht kërkesës së OE-se për konfidencialitet nuk e bën automatikisht tërë ofertën sekrete. Sipas neni 11.3 të LPP-së dhe vetë Aneksit 3 të Dosjes së Tenderit, duhet të identifikohen saktë pjesët e dokumenteve dhe të arsyetohet bindshëm dëmi material komercial. AK duhet ta shqyrtojë dhe ta pranojë klasifikimin vetëm për elementet që i plotësojnë të gjitha kushtet ligjore dhe ne si kompani detyrimisht përmes të autorizuarve tane do ta njoftojmë agjencionin për informim dhe provatesi për abuzimet e tilla dhe fshehjen e provave.

Për dokumentet me përmbajtje të përzier apo mikse, neni 11, par, 4 kërkon version të “pastruar”, ku hiqen vetëm elementet sekrete, si rrjedhojë e kësaj nëse i tërë dokumenti

klasifikohet ligjërisht si sekret afarist, neni 11.5 kërkon një përmbledhje të përgjithshme jo-sekrete ku edhe paragrafi, 6.3 i nenit 7 te Rregullores nr. 001/2022, për Prokurimin Publik, të ndryshuar - plotësuar me Rregulloren nr. 002/2024, kërkon që pas publikimit të formularit B58 Zyrtari i Prokurimit të ofrojë qasje të menjëhershme në versionin e pastruar dhe të mbajë procesverbal.

Në rastin tonë nuk na është dorëzuar version i pastruar, përmbledhje jo-sekrete, kopje e kërkesës për konfidencialitet, vendimi/arsyetimi i AK-së për pranimin e saj, apo procesverbali i qasjes. Kjo cenon nenet 7, 10 dhe 11 të LPP-së dhe aftësinë tonë për të ushtruar mjet juridik efektiv brenda afatit të shkurtër pesëditor.

Dispozita te nenit. 11, i LPP-se, paragrafi 3, pika 3.3 dhe 4, përcaktojnë qe: *“OE, i cili deklaron ofertën konfidenciale duhet te argumentoi përmes deklaratës me shkrim, ku domosdo duhet te vërtetohet se ndonjëri nga elementet e tenderit nuk është prone publike dhe te dhënat mbrohen dhe ne detaje do te arsyetohet konfidencialiteti apo sekreti ku zbulimi i tyre do te rezultonte me dëmtim material apo komercial te operatorit ekonomik”*.

Ndërsa paragrafi 4 i nenit 11, te LPP-se përcakton se, *“Autoriteti kontraktues që e ka klasifikuar një element të informatës si informatë sekrete afariste sipas paragrafit 3. të këtij neni, do të përgatit versionin e “pastruar” të çdo dokument...”*

Raportet dhe leter referenca, marreveshjet e bashkepunimit, certifikimet e stafit dhe kualifikimet, përkatësisht pervoja e punes dhe qeshtjet tjera janë mohuar ti prezantonjne dhe për te njejtat nuk eshte ofruar qasje, rrjedhimisht eshte mohuar e drejta e cila është kategori kushtetuese dhe e drejta për ankese.

Ligjërisht sekret afarist mund te konsiderohen vetëm te dhënat personale. AK Spitali i Pergjigthesem - Gjilan, zyra e Prokurimit, ne kuptim te paragrafit 4 te nenit 11 te LPP-se, është dashur ta përgatise versionin e pastruar te dokumenteve ndaj OE te rekomanduar për dhënie te kontratës, rrjedhimisht me mos ofrim te qasjes, AK , ka shkelur edhe dispozitat e nenit 10 te LPP-se - mjetet për promovimin e transparencës.

E drejta për qasje ne dokumente publike është e drejte bazike madje e garantuar me Kushtetute te Republikës se Kosovës, e qe sipas nenit 41 perkufizohet qe:

1. *Secili person gëzon të drejtën të qasjes në dokumente publike.*
2. *Dokumentet që mbajnë institucionet publike dhe organet e pushtetit shtetëror, janë publike, me përjashtim të informacioneve që janë të kufizuara me ligj, për shkak të privatësisë, të sekreteve afariste ose të informacioneve të klasifikuara të sigurisë.*

Neni 97 i Rregullores për prokurim publik nr. 001/2022, pika C), mos ofrimin e qasjes e klasifikon si shkelje te rende te ligjit për prokurim publik.

c) Mos lejimi dhe/ose neglizhimi i qasjes në dokumenteve zyrtare sipas kërkesës me shkrim të parashtruar nga pala e interesit kur një qasje e tillë e kërkuar është në përputhje me nenin 10 dhe 11 të Ligjit të Prokurimit Publik.

Qasja e plote ne dokumente publike eshtë e garantuar edhe me nënparagrafin 3.2, te nenit 17 te ligjit nr. 06/L081, për Qasje ne Dokumente Publike, si dhe me nenin 12, 13 dhe 14, te ligjit nr. 06/L-082, për Mbrojtjen e te dhënave personale.

- Madje për këtë qeshje OSHP, ka nxjerre dhjetra vendime ku mohimi i qasjes ne dokumente publike eshtë gjykuar ndryshe nga ju si AK madje edhe është sanksionuar.
- Si analogji dhe konsistence mund ti referoheni vendimit me nr. **606/23 ; 877/23** e shum vendime tjera publike ne ueb faqen e OSHP-se: <https://oshp.rks-gov.net>.

Për mos ofrim te qasjes ne dokumente publike edhe Agjencia për Informim dhe Privatesi ka te nxjerre me dhjetra vendime për mos ofrim te qasjes madje edhe ndeshkime: (shiqo vendimin me nr. **770/2024**; vendimi nr. **875/2024** – www.aip.rks-gov.net.

Pretendimi ankimor 5

AK, ka rekomanduar për dhenie të kontratës ofertë të pa pergjegjeshme kundrejt kerkesave te kapacitetit teknik dhe profesional pasi qe ne qasjen e mohuar dhe shqimit te paket vizual dhe te pa prezantuar me dokumente kemi arritur të shohim se katalogët publikë që korrespondojnë me produktet e ofruara nga OE KOMED nuk i plotesojne specifikat teknike te produkteve te kerkuara.

Me qene se AK nuk na ka ofruar kurrefare kopje apo version të pastruar ose përmbledhje jo-sekrete të ofertës, dhe per kete nuk kemi pasur mundësi të verifikojmë numrin e saktë të faqes dhe çdo dokument shtesë të dorëzuar

Për këtë arsye me poshte dallojme mospërputhjet që dalin drejtpërdrejt nga vlerat e publikuara prej kërkesave që katalogu nuk i dokumenton.

Barra për të provuar pajtueshmërinë e plotë me Aneksin 1 mbetet mbi OE-në e rekomanduar dhe AK-se, që e ka shpallur si te përgjegjshëm dhe se para Panelit te Organit Shqyrtues te Prokurimit i cili do ta trajtoj kete ankese duhet te shpjegohet se si është oferta e tyre e pergjegjeshme ndaj kerkesave kualifikuese dhe specifikave teknike te produkteve te kerkuara ne aneksin 1 te dosjes se tenderit.

Dosja e Tenderit, pika 3.1, kërkon që furnizimet të jenë në pajtim të plotë me Aneksin 1 dhe që kjo të demonstrohet me provat e dokumentuara të përcaktuara në FDT ndersa pika 3.2, shprehet se cilido specifikim që nuk është në përputhshmëri e diskualifikon tenderin ndersa kërkesa dhe evidenca 3, e FDT-së kërkojnë bashkërisht deklaratën për specifikimin teknik dhe katalogun origjinal të prodhuesit. Prandaj, një deklaratë e përgjithshme “po” nuk mund ta zëvendësojë mungesën e provës në katalog, dhe i njëjti standard që AK përdori ndaj ofertës sonë duhet të zbatohet edhe ndaj OE-së së rekomanduar.

- **9.1 Aparati i hemodializës DIANOVA X1 — Dialife SA**

Më poshtë po listojmë kriteret që kompania jonë pretendon qe OE i rekomanduar për kontratë nuk i plotëson.

- Katalogjet dhe manualët e përdorimit të paisjes në fjalë nuk citojnë ose deklarojnë që paisja plotëson kushtin e parë të kërkuar të Specifikimit teknike për këtë paisje *“Machine should have a modular design.”*

Paisja e ofruar nuk plotëson kriterin *“Before the start of the HD treatment, the machine must be capable of automatic Dialyzer Rinsing.”*

Katalogu nuk identifikon si kërkesa të provuara dizajnin modular (*Machine should have a modular design*); shpëlarjen automatike të dializatorit para trajtimit (*“Before the start of the HD treatment, the machine must be capable of automatic Dialyzer Rinsing.”*); ultrafiltrimin sekuencial (*Sequential Ultrafiltration facility*); sistemin volumetrik të ultrafiltrimit (*Volumetric Ultrafiltration System*); diapazonet e veçanta të sistolës e ka të cekur vetëm nivelin e lartë 40mmHg dhe nuk e ka të cekur nivelin e lartë.

Dokumentet e paisjes nuk kanë të cekur dhe të gjitha alarmet e kërkuara për humbje të ujit (*Loss of water*), *Conductivity*, temperaturë të lartë e të ulët (*Temperature high, Temperature low*).

Nuk dokumentohet as kërkesa që pajisja të bëjë vetë-testim gjatë trajtimit. Prezantimi publik i DIANOVA përshkruan “quick self-test” para trajtimit, duke filluar nga trajtimi i dytë i ditës, pasi testi i plotë të jetë bërë para trajtimit të parë. Ky funksion para trajtimit nuk është i njëjtë me vetë-testimin “during treatment” që e kërkon Aneksi 1. Po kështu, nuk dokumentohet ndezja dhe fikja automatike e programueshme paraprakisht për dezinfektim dhe fillim të terapisë (*The device must be able to automatically turn on and off, so that it is possible to pre-program it for disinfection and the start of therapy.*).

Për shfaqjen e të dhënave në ekran, katalogu publik nuk provon shfaqjen e njëkohshme të të dhënave (*The machine should Display the following: Trans membrane pressure, Conductivity, Flow rate, Elapsed time, Prescribed time, Kt/V*) sipas listës së Aneksit 1 të gjitha këto duhet të shfaqen në ekranin e paisjes së ofruar. Materiali i paisjes përmend regjistrimin dhe eksportimin e të dhënave të trajtimit, por nuk provon minimumin prej dhjetë historive të trajtimit së bashku me historikun e dezinfektimit ashtu si është kërkuar në Aneksin 1 (*History/Log for: HD Treatments (min. 10 treatment's), Disinfection*) në dokumentet publike nuk përmendet numri i trajtimeve që paisja regjistron.

Askund në dokumentet zyrtare të prodhuesit të kësaj paisje nuk përmendet që paisja nuk është e zhurmshme ashtu si kërkohet në Aneksin 1 (*The device should have minimal noise, in order to offer comfort to the patient during the treatment*), kjo ndikon direkt në komoditetin e pacientit.

- 9.2 Analizatori ISE i prodhuesit Caretium

Nga dokumenti që mundëm ta shihnim shkurtimisht dhe nga manuali publik që korrespondon me konfigurimin Caretium XI-931C/CT, analizatori përdor teknologjinë ISE dhe ofron K^+ , Na^+ , Cl^- , nCa^{2+} , iCa^{2+} , TCa dhe pH. Megjithatë, manuali nuk dokumenton parametrin e veçantë të llogaritur pH (37°C) që Aneksi 1 e kërkon për korrigjimin e iCa . Përkundrazi, manuali sqaron se pH i matur përdoret për të kalibruar nCa^{2+} dhe se vlera e pH-së e dhënë nga pajisja nuk pasqyron pH-në reale të gjakut. Prandaj, prania e pH-së dhe nCa^{2+} nuk provon automatikisht parametrin e kërkuar pH (37°C), dhe AK duhet të identifikojë faqen konkrete të katalogut ku ky parametër vërtetohet.

Mospërputhja tjetër e drejtpërdrejtë ka të bëjë me kushtet e punës. Aneksi 1 kërkon temperaturë operative 15–32°C. Manuali Caretium XI-931 përcakton 10–30°C. Ky diapazon nuk e mbulon pjesën 30–32°C të kërkesës dhe rrjedhimisht nuk është përputhje e plotë me intervalin e Aneksit 1.

Edhe skema e kalibrimit nuk përputhet me kërkesën. Aneksi 1 kërkon kalibrim automatik dy-pikësh çdo katër orë ose sipas kërkesës dhe kalibrim një-pikësh me çdo mostër për kompensimin e temperaturës dhe driftit. Manuali Caretium përshkruan kalibrim automatik në ndezje dhe çdo dy orë vetëm gjatë gjendjes së pushimit; kalibrimi një-pikësh paraqitet si modifikim i faktorit me një kalibrator ose kontroll, jo si kalibrim automatik me çdo mostër për temperaturë dhe drift. Manuali nuk dokumenton skemën e kombinuar të kërkuar nga Aneksi 1.

Në lidhje me mënyrat e punës dhe kontrollin e cilësisë, Aneksi 1 kërkon “Standard mode” për përdorim ditor dhe “QC mode” për interpretim statistikor në dy nivele. Manuali Caretium përshkruan mënyra gjysmë-automatike dhe automatike dhe lejon QC me tri nivele; ai nuk dokumenton dy mënyrat e emëtuara dhe funksionalitetin e kërkuar sipas formulimit të FDT-së. Tri nivele QC mund të jenë kapacitet më i gjerë, por kjo nuk provon vetvetiu ekzistencën e “Standard mode” dhe strukturën e kërkuar të interpretimit statistikor. Katalogu gjithashtu nuk përcakton kushtin e posaçëm të mostrës së gjakut të plotë me heparinë mbi 10 U/mL, por vetëm rendit llojet e mostrës.

AK duhet të na japë menjëherë qasje në emërtimin e modelit dhe katalogun origjinal dhe ta tregojë, faqe për faqe, ku plotësohen pH (37°C), skema e kalibrimit, temperatura 15–32°C dhe mënyrat e punës të Aneksit 1.

Katalogët e prodhuesve, karakteristikat teknike dhe emri i modelit janë materiale thelbësore për vlerësimin e përgjegjshmërisë dhe, për më tepër, pjesa më e madhe e tyre është publike në internet. Informacioni që tashmë është publik nuk mund të trajtohet si sekret afarist vetëm sepse OE ka dorëzuar një kërkesë të përgjithshme për konfidencialitet. Refuzimi i kopjeve ka penguar pikërisht kontrollin e standardit të dyfishtë: oferta jonë u eliminua për dokumente që FDT nuk i kërkonte, ndërsa oferta e rekomanduar duket se është pranuar pa u provuar secili specifikim i detyrueshëm i Aneksit 1.

Pretendimi ankimor 6

Autoriteti Kontraktues, me rastin e nxjerrjes së Vendimit të datës 31.08.2026, ka vepruar në kundërshtim të me nenin 108/A të Ligjit për Prokurimin Publi, i cili e obligon AK-në që pas pranimi të kërkesës për rishqyrtim të zhvillojë shqyrtim të mirëfilltë administrativ dhe të nxjerrë një vendim të arsyetuar me shkrim për të gjitha faktet dhe pretendimet e ngritura, ndërsa në vendimin e kontestuar, AK ka aplikuar qasje thjesht formale dhe refuzuese fiktive, duke shmangur argumentet baziike dhe provat materiale.

Tek pretendimi mbi kapacitetin teknik lidhur me serviserin e certifikuar, ankuesi ka argumentuar dorëzimin e dy certifikatave, atë të prodhuesit *B. Braun* për Dion Bullatovci dhe të *Human* për Riste Soskoski ku pavaresisht ketije fakti AK, e kufizon minimizon pretendimin dhe i referohet vetëm certifikata e vitit 2007, të kompanisë Human, ndërsa nuk e shqyrton dhe nuk e vlerëson apo e anashkalon tërësisht certifikatën e lëshuar nga prodhuesi *B. Braun* për z. Bullatovci. Mosdhënia e përgjigjes ndaj provës shkresore të deponuar në ofertë përbën shkelje direkte të detyrimit ligjor për ekzaminim të plotë sipas nenit 108/A të LPP-së par 8 dhe 9.

Po ashtu ne pretendimin 5 të kërkesës për rishqyrtim, ne si ankues kemi paraqitur vërejtje konkrete dhe të detajuara teknike ndaj pajisjeve të ofertuara nga OE fitues "Komed LLC" përfshirë mungesën e dëshmisë në katalog për dizajnin modular, shpëlarjen automatike para trajtimit, vetë-testimin *gjatë* trajtimit, memorizimin e 10 trajtimeve për aparatin *DIANOVA XI*, si dhe mospërputhjen e parametrin pH (37°C) dhe intervalit të temperaturës 15–32°C për analizatorin *Caretium*).

Përkundër kësaj, AK nuk ka ballafaquar asnjë nga këto të dhëna me dokumentacionin teknik të OE fitues dhe nuk ka cituar asnjë faqe të vetme të katalogut apo specifikimit zyrtar.

Përgjigjja e AK-së është kufizuar në frazë të përgjithshme se "*OE i rekomanduar i ka të gjitha pikat e specifikimit teknik të plotësuar*" dhe se kjo mungesë e analizës krahasuese teknike nuk përbën arsyetim ligjor sipas nenit 108/A, por refuzim arbitrar.

Ngjashëm pretendimit për shkelje të neneve 10 dhe 11 të LPP-së dhe mosofrimi i versionit të redaktuar - pastruar, mungesa e vendimit për sekret afarist dhe mungesa e procesverbalit zyrtar, AK nuk jep arsyetim ligjor, por mjaftohet me arsyetimin: "*prishje gjenerale të internetit*". Kjo shpreheje dhe ky arsyetim tregon qarte për etike profesinale, nivel profesional dhe përgjegjësi zyrtare!

Prandaj marre parasyshe provat dhe faktet e prezantuara ne kerkete ankese kërkojmë qe OSHP, te autorizoi eksper te pa varur, profesional dhe te pa aneshme ne atë mënyrë qe e trajton ankesen ashtu siç kerkohet me nenin 113 te LPP-se dhe me pas paneli shqyrtues te nxjerre këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet** në tërësi si e bazuar ankesa e OE "Medi Health L.L.C." – Prishtinë.
- II. Anulohet** njoftimi mbi Vendimin e AK-së - Formulari B58 i datës 25.08.2026 për aktivitetin e prokurimit nr. 220/70001-26-5789-1-1-1.
- III. Kthehet** lënda në rivlerësim, duke urdhëruar AK-në të bëjë ekzaminim objektiv konform dosjes së tenderit dhe dispozitave të LPP-së.
- IV. Urdhërohet** AK që të zbatojë në plotni nenet 10 dhe 11 të LPP-së duke i siguruar ankuesit qasje të plotë në versionin e pastruar, të ofertës së OE të rekomanduar për kontratë.
- V. Lejohet** kthimi i mjeteve te deponuara ne emer të tarifës së ankesës konform nenit 118 të LPP-së.
- VI. Kerkohet** nga KRPP-së marrja e masave konform nenit 25, paragrafi 8 i LPP-së, ndaj personit përgjegjës – zyrtarit te prokurimit për shkeljet e përsëritura ligjore.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Te shumefishta por ne procedur tjera eventuale do te kerkohet qe te kompensohen.

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.*
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
- e) bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,*
- f) Dëshminë e pagesës se tarifës se ankimit ne përputhje me nenin 118 te LPP-se, dhe*
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*